



Pranimar / Dorezuar Prinjevoj / Predato Received / Delivered	21.04 2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	No Prot Br Prot Prot No	Shtupja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/STK/1925/2021			1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.236/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca - kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani - anëtarë, si dhe Hysni Mustafa-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2536/19 të datës 22.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.324/2019 të datës 12.06.2019 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit-Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 21.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON PROCEDIMI administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.324/2019 të datës 12.06.2019 të parashtruar nga ankuesi për shkak se objekti i ankesës është bërë i pamundur.

A r s y e t i m

Administrata Tatimore e Kosovës më datë 05.06.2019 ka shpallur konkurs të brendshëm për plotësimin e pozitës "Zëvendës drejtor i Përgjithshëm për Programe dhe Procedura", të cilën pozitë ankuesi ka qenë duke e mbajtur sipas Vendimit me numër protokoll 191 të datës 16.03.2016.

Ankuesi më datë 12.06.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 11-06-2500 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, dhe ankesë me numër protokoll 2671/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për anulimin e konkursit të brendshëm për pozitën "Zëvendës drejtor i Përgjithshëm për Programe dhe Procedura".

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datë 18.06.2019 ka nxjerr Vendim me Nr.prot: 11/126 me të cilin ka aprovuar ankesën e ankuesit dhe ka anuluar konkursin e brendshëm për pozitën "Zëvendës drejtor i Përgjithshëm për Programe dhe Procedura", ndërsa Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës me qëllim të zbatimit të vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datë 19.06.2019 ka nxjerrë Vendim me Nr.prot: 346 përmes të cilit ka anuluar konkursin e brendshëm të datës 05.06.2019 për pozitën "Zëvendës drejtor i Përgjithshëm për Programe dhe Procedura".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 19.06.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Administratën Tatimore të Kosovës. Këshilli me datë 27.06.2019 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Administratën Tatimore të Kosovës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Përveç ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, ankuesi ka iniciuar konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ku kjo e fundit përmes Aktgjykimit A.nr.2536/19 të datës 01.04.2021 ka obliguar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shqyrtimin e ankesës të parashtruar me datë 06.09.2019 nga ankues.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën numër protokollit 2671/2019 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi Nr.11/191 i datës 16.03.2016; Akt Emërimit e ankuesit Nr.11/02/231/09 0074 të datës 28.02.2014; Akt emërimit e ankuesit Nr.11/02/231/09 të datës 23.02.2012; Akt emërimit e ankuesit Nr.11/02/231/09 të datës 28.02.2013; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018,; Kërkesën për përgjigje të datës 19.06.2019; Përgjigjen në kërkesë të datës 27.06.2019; Konkursin e brendshëm Nr.11/271 të datës 05.06.2019 të ATK-së; Ankesën e ankuesit Nr.11-06-2500 të datës 12.06.2019 drejtuar KZKA-së; Procesverbalin e KZKA-së të datës 17.06.2019 për shqyrtimin e ankesës së ankuesit; Vendimin e KZKA-së Nr.11/126 të datës 18.06.2019; Vendimin Nr.11/346 të datës 19.06.2019 për anulimin e konkursit të datës 05.06.2019.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur, *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit dhe pas analizimit të të gjitha provave të lëndës, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës më datë 18.06.2019 ka nxjerrë Vendim me Nr.prot:126 përmes të cilit ka aprovuar ankesën e ankuesit dhe ka anuluar konkursin e brendshëm për pozitën "Zëvendës drejtor i Përgjithshëm për Programe dhe Procedura", ndërsa me qëllim të zbatimit të këtij vendimi Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës më datë 19.06.2019 ka nxjerrë Vendim me Nr.prot: 346 me të cilin ka anuluar konkursin e brendshëm për pozitën "Zëvendës drejtor i Përgjithshëm për Programe dhe Procedura".



Andaj, duke marr parasysh se konkursi i brendshëm për të cilin ankuesi është ankuar është anuluar dhe meqenëse pretendimi ankimor i ankuesit është përmbushur, Kolegji vlerëson se objekti për të cilin kishte filluar procedimi administrativ më ankesën e ankuesit është bërë i pamundur ashtu siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 104 ku përcaktohet se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*”.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.236/2021

Hysni MUSTAFA

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës;
- Arkivit të KPMShCK-së.

